



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.5.2023

Nr: 68

Ora: 21:00

U R D H Ë R

PËR

SHPËRNDARJEN E MATERIALEVE ZGJEDHORE NË KZAZ-TË E BASHKIVE ELBASAN, KAMËZ DHE VORË KU DO TË ZHVILLOHET PROCESI I VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK, PËR ZGJEDHJET E DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar

U R D H Ë R O J:

1. Komisionet e Zonave së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë të dorëzojnë në çdo KQV, pajisjen e identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), kameran që do të vendoset në qendrën e votimit, kutinë e materialeve zgjedhore dhe dokumentacionin e punës së KQV-së.
2. KZAZ-të nuk do t'u dorëzojnë KQV-së, fletët e votimit dhe kutitë e votimit për kandidatët për kryetar bashkie dhe për këshillin e bashkisë.
3. Dërgimi i fletëve të votimit dhe kutive të votimit për kandidatët për kryetar bashkie dhe për këshillin e bashkisë do të bëhet vetëm me urdhërim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
4. Ngarkohen administrata e KQZ-së, KZAZ-të dhe KQV-të e bashkive Elbasan, Kamëz dhe Vorë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 12.5.2023 Nr.68
Ora:21:00



“Për shpërndarjen e materialeve zgjedhore në KZAZ-të e bashkive Elbasan, Kamëz dhe Vorë ku do të zhvillohet procesi i votimit dhe numërimit elektronik për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023”